



KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren  
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



Bordi i Drejtorëve në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" SH.A me seli në Prizren, në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligjit Nr.04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.08.2025, mori këtë:

**VENDIM**  
**RAPORTI-TM2-2025**



Bordi i Drejtorëve njëzëri miratoi raportin e TM2 për vitin 2025 në mbledhjen e 6 (gjashtë) të mbajtur me datë 29.08.2025.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	<b>UD. Kryeshef Ekzekutiv Fadil Berisha</b>	<b>Kryesuesi i BD Ylber Elshani</b>
Nënshkrimi		
Data	29.08.2025	29.08.2025



KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren  
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com



# RAPORT – TM2 2025

KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A. – PRIZREN

## Përmbajtje

ZONA E PËRGJEGJËSISË SË SHËRBIMEVE .....	3
<b>I. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV .....</b>	<b>4</b>
1.1 Aktivitetet kryesore .....	4
1.2 Të arriturat kryesore.....	5
1.3 Problemet që kanë ndikuar në realizimin e objektivave.....	6
1.4 Masat e propozuara .....	7
<b>2 DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES .....</b>	<b>8</b>
2.1 Situata e furnizimit .....	8
2.2 Prodhimi.....	8
2.3 Aktivitetet kryesore .....	9
2.4 Cilësia e ujit të pijes .....	9
<b>3 DEPARTAMENTI KOMERCIAL.....</b>	<b>11</b>
3.1 Numri i konsumatorëve .....	11
3.2 Faturimi m3 .....	11
3.4 Inspektimi dhe Shkyçja .....	12
<b>4 DEPARTAMENTI I FINANCAVE .....</b>	<b>13</b>
4.1 Aktivitetet kryesore .....	13
4.2 Faturimi €.....	14
4.3 Arkëtimi € .....	14
4.4 Arsyeshmëria e shpenzimeve .....	15
4.5 Transaksionet kryesore .....	16
<b>5 DEPARTAMENTI I UJËRAVE TË NDOTURA .....</b>	<b>17</b>
5.1 Aktivitetet e përgjithshme .....	17
5.2 Statusi i projektit, Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Prizrenit- Faza V dhe VI	

VI.	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	21
6.1	Aktivitetet kryesore .....	21
VII.	PLANI I VEPRIMIT - UPF .....	23
7.1.	AKTIVITETET SIPAS PLANIT TË VEPRIMIT (UPF) .....	23
7.1.1.	Ndarja e Zonave DMA (Zonat e Matura të Ujit – ZMU) .....	23
7.1.2.	Konsolidimi i databazës së konsumatorëve:.....	25
7.1.3.	Eliminimi i kyçjeve ilegale dhe konsumit të pa autorizuar:.....	25
7.1.4.	Faturimi i konsumatorëve që reflekton saktësisht ujin e konsumuar: instalimi i ujëmatësve për të gjithë konsumatorët dhe sigurimi i saktësisë së matjes dhe leximit:.....	25
7.1.5.	Krijimi i sistemit efektiv për identifikimin dhe riparimin e shpejt të rrjedhjeve të dukshme	26
7.1.6.	Hulumtimi, detektimi dhe riparimi sistematik i rrjedhjeve të padukshme (nëntokësore).....	26
7.2.	RAPORTI I EKIPIT TË NDËRRIMIT TË UJËMATËSAVE.....	27
7.2.1.	Vendosja e standardit për riparimin brenda 5 ditëve të të gjitha rrjedhjeve të raportuara.....	28
7.2.2.	Zëvendësimi i infrastrukturës së vjetëruar të ujësjellësit (rrjetit shpërndarës dhe kyçjeve shtëpiake) .....	28
7.3.	Hapat e ardhshëm për zvogëlimin e humbjeve të ujit.....	28
VIII.	PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE.....	29
8.1	PERFORMANCAT KRYESORE – TM1- TM2-2025 .....	29
8.2	PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE – TM2- 2025 .....	30
8.3	KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” – TM1- 2024-2025 .....	31
8.4	REALIZIMI I CAQEVE - KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” – TM2-2025 .....	32
8.5	RAPORTI FINANCIAR - KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” – TM2-2025 .....	33
IX.	ORGANOGRAMI .....	35
	SHTESA 1: PROCEDURAT E PROKURIMIT JANAR-KORRIK 2025 .....	36
	SHTESA 2: Lista e investimeve nga mjetet vetanake të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A.....	38

# ZONA E PËRGJEGJËSISË SË SHËRBIMEVE

**ZONAT E PËRGJEGJËSISË SE K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A**  
**KRU" HIDROREGJIONI JUGOR" Sh.A Prizren**  
Mbulueshmëria me shërbime të ujësjetësit, viti 2023



LEGJENDA

05	zona e shërbimit
06	qytetet dhe qyt.
07	komunitet me ujë të ftohshëm nga sht.
1.18	si përzierje të shërbimit të ujësjetësit

Punoi: Shërbimi TEKNIK

# I. AKTIVITETET E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

## 1.1 Aktivitetet kryesore

- Monitorimin e burimeve te ujit
- Monitorimin e stacioneve te pompimit
- Evidentimin dhe rregullimin e defekteve
- Evidentimin dhe shkyçjen e lidhjeve ilegale
- Përfundimin sa me te shpejte te projekteve kapitale (Me mjete vetanake)
- Monitorimin te projekteve kapitale te filluara ( Nga Kuvendi Komunal)
- Takimet e rregullta të menaxhmentit
- Takimet me institucionet komunale, qeveritare, institucione financiare donatore, operatorët ekonomik, me konsumatorë, palë tjera të interest, etj.
- ARRU – Aplikimi tarifor
- SHUKOS – Diskutimi i problemit të energjisë elektrike
- Takime me Donatorë: në kuadër të projektit për "Rritjen e Reziliencës ndaj Ndryshimeve Klimatike në Sektorin e Ujit në Kosovë"
  
- Pjesëmarrje në punëtorinë për Planin Zhvillimor Komunal,- Prizren, me fokus në përcaktimin e prioriteteve dhe kontributin institucional për zhvillim të qëndrueshëm (Takimet e rregullta të menaxhmentit
- Organizim i takimeve me komunat (Prizren, Suhareke, Dragash dhe Malisheve)
- Marrëveshje bashkëfinancimi me Komunën për rrjetin e ujësjellësit.
- Pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga KK-Prizrenit, me temë "Plani Zhvillimor Komunal" (PZHK) 2025-2035.
- Pjesëmarrës dhe raportues në mbledhjen e asamblesë së KK- Prizrenit "Raporti 6-mujor i KK-Prizren".
- Fillimi i implementimit te projektit UoF me Bankën Botërore,
- Workshope me ARRU, plotesimi i aplikacionit per Aplikim Tarifor(2026-2028)
- Takime ne zyre te KRU dhe zyre te ME, shekembimi i te dhenave te KRU per projektin "Resilienca Klimatike ne sektorin e Ujit ne Kosove".
- Fillim i implementimit të platformave të reja (SISHU, MMS).
- Takim me perfaqësues të lagjeve dhe komuniteteve për zgjidhjen e problemeve rreth furnizimit me ujë.

### Investime dhe Projekte të Realizuara :

- **Përfunduar:**
  - Rehabilitimi i gypit Ø400mm nga materiali AC dhe integrimi i burimit alternativ në sistemin ekzsitruës në Prizren.
  - Bashkëfinancim me komunën e Prizrenit - Rehabilitimi i rrjetëve në rrugët "Adem Jashari", "Edit Durham" dhe "Adriatiku".
  - Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private be rr. "Imer Krasniqi" në Malishevë.

- Në proces:
  - Rehabilitimi i në rr. "Xheme Gostivari" – Prizren.
  - Vendosja e pusetave jashtë pronës private – Malishevë.
  - Renovimi i zyrave të laboratorit, ndërtimi i objektit të Klorinatorit.

#### Aktivitetet Operative

- **Sanimi i defekteve:** 531 ndërhyrje në total
  - Prizren: 396
  - Suharekë: 77
  - Dragash: 11
  - Malishevë: 47
- **Kontrolle, ndërrime & mirëmbajtje:**
  - 569 ndërrime të ujëmatësve.
  - 180 detektive në rrjet, 122 defekte të identifikuar.
  - 13,520 metra rrjet i detektuar.
- Faza e përfundimit të punimeve dhe përgaditja e dokumentacionit për pranimit teknik të projektit "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellesit dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronës private në Rr. Imer Krasniqi" – Malisheve.
- Përgaditja e projektit ideor "Dislokimi i gypit Ø160mm nga burimi i Cvilen-it"

## 1.2 Të arriturat kryesore

### TM1-TM2 -2025

- Rritja e aktiviteteve të ekipeve të inspektoratit;
  - Shkycje të lidhjeve ilegale: 245
  - Shkycje për mos pagesë: 746
  - Shkycje totale: 988
  - 58 Raste tek përmbartuesit privat
- Prodhimi – m<sup>3</sup> për +13.5% (+1,097,317 m<sup>3</sup>)
- Faturimi – m<sup>3</sup> për +4.7% (+92,160 m<sup>3</sup>)
- Faturimi - € për +8.5% (+114,440.00 €)
- Arkëtimet -€ për + 3.1% (+41,054.00€)
- % e Arkëtimit ; -4.8% (93.4%)
- Numri i konsumatorëve ; +1.0% (+631)
- Shpenzimet -€ për + 12.1% (+150,699.67€)
- UPF; +1.9% ( nga 75.9 % në + 77.8%)
- Mbulimi operativ ; 0.98 ( nga +1.06)
- Mbulimi operativ €; - 30,966.08 €

## REALIZIMI I CAQEVE TM2-2025

• Prodhimi - m3 -	112.6 %
• Faturimi - m3 -	82.8 %
• Faturimi - € -	86.8 %
• Arkëtimit -€ -	83.8 %
• % e arkëtimit -	97.2 %
• Numri i konsumatorëve –	102 %
• Shpenzimeve- €-	91.0%
• Mbulimi operativ -	94.1%
• UPF - %	89.7%

### 1.3 Problemet që kanë ndikuar në realizimin e objektivave

- Rënia e nivelit të burimeve ne disa zona te caktuara sidomos ne Malishevë dhe disa fshatra te Suharekës
- Reduktimet ne zona te caktuara (si pasoje edhe e mungesës se ujit ne burime ne Malishevë dhe disa fshatra te Suharekës)
- Defektet e shumta në rrjet.
- Vonesat ne proceduat e prokurimit
- Mungesa e mjeteve te punës (Eskavatorë, kamioneta, etj.)
- Keqpërdorimet e ujit
- Numri i orëve jashtë orarit, ne veçanti nga shërbimi i operatives. (si pasoje edhe e reduktimeve dhe numrit të madhe të defekteve)
- Mungesa e ndarjes se zonave te furnizimit dhe zonave te presionit
- Numri i madhe i konsumatorëve pa konsum. (Shtëpi dhe banesa te pa banuara)
- Humbjet e mëdha te ujit – humbjet e autorizuara (rrjedhjet nga defektet dhe kapërderdhës)
- Numri i madhe i ujëmatësve me te vjetër se pese vite.
- Mos plotësimi i vendeve te punës për pozitat me ushtrues detyre.
- Mos zgjidhja e problemit te objektit të administratës
- Amortizimi i makinerisë se vjetër te punës
- Mos pagesa e obligimeve nga Kuvendet Komunale
- Rritja e çmimeve te energjisë elektrike
- Vonesa e fillimit te investimeve nga KK
- Probleme me ndërprerje të ujit në Malishevë për shkak të defekteve dhe mungesës së ekskavatorit, si dhe problemeve në rehabilitimin e stacionit të pompave “Banjë” duke vonuar sanimet.
- Numri i larte i konsumatorëve pa konsum (vetëm me tarif fikse)

## 1.4 Masat e propozuara

- Zbatim i planit të veprimit për zvogëlimin e UPF-se
- Zbatimi i plotei MMS-sit
- Perfundimi i projekteve kapitale të inicuar
- Pajisja me mjete të punës (eskavator, kamionet etj)
- Funksionalizimi i plote i qendrës së thirrjeve (24 ore)
- Vazhdimi i blombimit të ujëmatësve.
- Rifreskimi i të dhënave të konsumatorëve.
- Identifikimi dhe dorëzimi i faturave tek konsumatorët edhe në formë elektronike.
- Riorganizimi i shërbimit të operativës
- Rishikimi i nivelizimit të pagave dhe përshkrimit të vendeve të punës
- Forcimi i sektorit për zvogëlimin e humbjeve të ujit
- Rritja e disiplinës në punë
- Rritja e efikasitetit të punës
- Përfundimi i projekteve me prioritet, rehabilitimin e burimeve ekzistuese dhe zvogëlimin e humbjeve teknike
- Funksionalizimi i plote i sistemeve të komunikimit (në burime dhe rezervuar)
- Përgatitja e rregullores për angazhimin e praktikanteve me kompenzim
- Plotësimi i standardeve të shërbimeve
- Rritja e aktiviteteve të shërbimit të ndërrimit të ujëmatësve
- Rritja e aktiviteteve në shkyçjen e konsumatorëve ilegal, shkyçjeve për mos pagesë dhe dërgimit të rasteve tek përmbauesit privat
- Përgatitja e kampanjës për sensibilizimin e konsumatorëve për kursimin e ujit, rëndësinë e ujit, si dhe kryerjen e obligimeve ndaj kompanisë
- Vizita dhe inspektimi me prioritet- sallonet e dasmave
- Vizita dhe inspektimi i konsumatorëve pak konsum
- Rritja e dërgimit të rasteve tek përmbauesit privat
- Fushatë vetëdijësuese për konsumatorë
- Zgjatja e orarit të punës për portoarka
- Qasja në platformën E-Kosova
- Përgatitja e projekteve ideore për rehabilitimin e rrjetit ekzistues
- Monitorimi i projekteve të financuara nga Qeveria dhe Kuvendi Komunal
- Definimi i DMA zonave të reja
- Monitorimi i DMA zonave- Aktivitetet konkrete
- Rishikimi i rregullores për sistematizim të vendeve të punës
- Aplikimi i jashtëzakonshëm tarifor

## 2 DEPARTAMENTI I UJIT TË PIJES

### 2.1 Situata e furnizimit

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijshëm për muajt Prill-Qershor 2025, në nivel rajonal dhe në të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë i rregullt dhe stabil, me përjashtim të njësisë së Malishevës dhe disa zonave më të larta ku është regjistruar rënie e presionit. Ky fenomen është shfaqur kryesisht për shkak të kushteve të pafavorshme gjeografike dhe infrastrukturës së vjetruar të rrjetit shpërndarës.

Në krahasim me muajt paraprak, furnizimi në muajt Prill-Qershor 2025, ka qenë dukshëm më i qëndrueshëm dhe më pranë standardeve optimale të furnizimit 24-orësh me cilësi 100% të ujit të pijshëm. Ky përmirësim është rezultat i masave të vazhdueshme të ndërmarra në operim, mirëmbajtje dhe monitorim intensiv të sistemit të ujësjellësit.

Reduktimet apo mungesat e furnizimit që ishin evidente në muajt Janar-Mars, gjatë muajve Prill-Qershor janë shmangur pothuajse plotësisht me përjashtim të fshatit Zhur ne Prizren, Ne Suahrekë; fshati Gjinoc, Doberdelan dhe Sallagrahdë dhe disa rrugëve në njësin e Malishevës(Carralluk, Banjë, lagjja Mirdita), duke mbetur vetëm çështja e defekteve të ndodhura në zona të ndryshme, për shkak të karakteristikave teknike dhe fizike të rrjetit. Kompania vazhdon të ndërmarrë masa për modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës hidroteknike dhe elektro-mekanike, duke synuar sigurimin e një furnizimi të qëndrueshëm dhe cilësor të ujit për të gjithë konsumatorët në zonën e mbulueshmërisë.

Përpjekjet për investime kapitale janë intensifikuar, duke synuar zgjidhjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të problemeve teknike dhe infrastrukturës së vjetër si dhe menaxhimin efikas të burimeve ujore në kushtet aktuale klimatike.

### 2.2 Prodhimi

TM1-TM2- 2025

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN

PRODHIMI - TM2-2025

TM1-TM2- 2025								
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A - PRIZREN								
PRODHIMI - m3								
NJËSIA PUNUESE	TM1-2025		TM2-2025		DALLIMI		%	
	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	796.9	6,196,505	908.7	7,144,709	120.6	948,204	15.1%	15.3%
SUHAREKË	146.7	1,140,375	152.4	1,198,481	7.4	58,106	5.0%	5.1%
MALISHEVË	78.1	607,639	88.0	691,908	10.7	84,269	13.7%	13.9%
DRAGASH	25.3	196,524	25.9	203,262	0.9	6,738	3.4%	3.4%
TOTAL	1,046.9	8,141,043	1,175.0	9,238,360	139.6	1,097,317	13.3%	13.5%

\* Rritja e prodhimit të ujit gjatë TM2 2025 është rezultat i dy faktorëve kyç: përmirësimit të nivelit të ujit në burime dhe ndikimit të infrastrukturës ekzistuese në rrjetin shpërndarës. Gjatë fundit të vitit 2024 dhe fillimit të vitit 2025, burimet ujore kanë shënuar rënie të ndjeshme, duke ndikuar negativisht në kapacitetin prodhues. Megjithatë, në tremujorin e dytë të vitit 2025 është vërejtur rritje e ndjeshme e nivelit të ujit në burime, çka ka ndihmuar në rritjen e prodhimit dhe stabilizimin e furnizimit në disa zona. Nga ana tjetër, niveli i lartë i defekteve në rrjet dhe amortizimi i rrjetit ekzistues vazhdojnë të kenë ndikim negativ, duke kontribuar si në rritjen artificiale të kërkesës për prodhim, ashtu edhe në humbje të konsiderueshme të ujit gjatë shpërndarjes. Ky kombinim faktorësh evidenton nevojën për investime të vazhdueshme në rehabilitimin dhe modernizimin e rrjetit të ujësjellësit, në mënyrë që prodhimi i shtuar të shoqërohet me efikasitet më të lartë dhe humbje më të ulëta.

### 2.3 Aktivitetet kryesore

#### Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve – TM2- 2025

Njësia Operative	Ujësjellësi - uji i pijes
Prizren	396
Suharekë	77
Dragash	11
Malishevë	47
<b>Total</b>	<b>531</b>

\* Aktivitetet e grupeve janë të paraqitura në tabelë.

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti Teknik		
Grupet	Aktivitetet e grupeve TM2- 2025	
Kalibrim i ujëmatësve	39	riparime të ujëmatësve
Ndërrimi i ujëmatësve (D-M)	569	vizita të konsumatorët
	278	ndërrime të ujëmatësve
	75	riparim të defekteve gjatë ndërrimit
Detektimit të rrjetit	180	detektive
	122	defekte të gjetura
	13,520	rrjet i detektuar (m)

### 2.4 Cilësia e ujit të pijes

- Kontrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje në Qytet ,si dhe kontrollimi i klorit në fshatra.
- Kontrolli permanent i kualitetit të ujit në burime si dhe të puseve të cilat shfrytëzohen për momentin.
- Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorinimit për të percjellur punën e procesit të klorinimit dhe paisjeve.

- Marrja e mostrave sipas Planit per monitorim te cilesis se ujit.
- Vazhduan punimet ne renovimin e hapsirave në Zyre ashtu edhe në Laborator.
- Filluan punimet në ndertimin e objektit te stacionit te klorinimit në „40-Burime”.
- Furnizim i stacioneve të klorinimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.

#### Rezultata e analizave nga IKSHP – TM2-2025

NJËSIA	LLOJI I UJIT	NR. I MOSTRAVE	NUK I PËRGJIGJEN
PRIZREN	Ujësjiellës	468	0
SUHAREKË	Ujësjiellës	32	2
MALISHEVË	Ujësjiellës	68	0
DRAGASH	Ujësjiellës	54	4
<b>TOTAL</b>	<b>Ujësjiellës</b>	<b>622</b>	<b>6</b>

- Mostra te cilat nuk i përgjigjen standardit për ujin e pijes janë 4 të marra në Dragash : Bakt,Turb, dhe Fe ,Mn, pH.( Reshje te medha muaji Prill)
- Mostrat te cilat nuk i përgjigjen standardit për ujin e pijes janë marrë në Dragash të dyja ,prezentë turbiditeti i shtuar dhe prezenca e NH<sub>4</sub> dhe KMnO<sub>4</sub> (ndotje me prejardhje shtazore ) Shkaku i mospërputhjes me standardin e ujit te pijes ishin te reshurat e mëdha dhe mundësia e filtrimit me filtrat ekzistuese është shumë e kufizuar( Qershor ).
- Mostrat e marra në Suharekë 2 nuk i përgjigjen standardit për ujin e pijes :Bakt. E gjalla ,E Koli,dhe kolif. ( mungesë Klori).( Suharekë).

#### Rezultata e analizave nga Laboratori - KRU – TM2-2025

TM-1	Lloji furnizimit	Mostra Totali	Bakterologjike			Fiziko-Kimike		
			Nr. Mostrave	Përgjigjet	Nuk përgjigjet	Nr. Mostrave	Përgjigjet	Nuk përgjigjet
Prill 2025	Burim	52	26	10	16	26	26	0
	Rrjet	148	74	74	0	74	74	0
Maj 2025	Burim	48	24	13	11	24	24	0
	Rrjet	128	64	64	0	64	64	0
Qershor 2025	Burim	36	18	5	13	18	18	0
	Rrjet	96	48	48	0	48	48	0
Totali	Burim	136	68	28	40	68	68	0
	Rrjet	372	186	186	0	186	186	0

### 3 DEPARTAMENTI KOMERCIAL

#### 3.1 Numri i konsumatorëve

TM1-TM2- 2025

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA			
No.	Të dhënat	TM1- 2025	TM2- 2025
1	Shtëpiak	55,663	56,240
2	Ndryshimi		577
3	Ndryshi. %		1.0%
4	Kome.-Indu.	6,989	7,040
5	Ndryshimi		51
6	Ndryshi. %		0.7%
7	Institucional	346	349
8	Ndryshimi		3
9	Ndryshi. %		0.9%
10	TOTAL	62,998	63,629
11	Ndryshimi		631
12	Ndryshi. %		1.00%

#### 3.2 Faturimi m3

TM1-TM2- 2025

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

FATURIMI - m3			
No.	Të dhënat	TM1- 2025	TM2- 2025
1	Shtëpiak	1,642,613	1,708,708
2	Ndryshimi		66,095
3	Ndry. %		4.0
4	Kome.-Indu.	194,335	182,720
5	Ndryshimi		(11,615)
6	Ndry. %		(6.0)
7	Institucional	121,741	159,421
8	Ndryshimi		37,680
9	Ndry. %		31.0
10	TOTAL	1,958,689	2,050,849
11	Ndryshimi		92,160
12	Ndry. %		4.5%

### 3.3 Ankesat teknike dhe komerciale

- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas kohës dhe prioritetit të tyre

#### TM2-2025 HRJ

1. Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	668
1.1 Rrjedhje e ujit	numër	406
1.2 Mungese e ujit	numër	162
1.3 Rënie e presionit	numër	86
1.4 Cilësia e ujit	numër	8
1.5 Të tjera	numër	6
<b>2. Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit</b>	<b>numër</b>	<b>74</b>
2.1 Kontestim i borxhit, faturës	numër	56
2.2 Verifikim i leximit të ujëmatësit /te tjera	numër	13
2.3 Te tjera	numër	5

### 3.4 Inspektimi dhe Shkyçja

Me intensitet të shtuar, kanë vazhduar kontrollet në teren nga ekipi i inspektimit tek konsumatorët, ku janë shpërndarë vërejtje për ndërprerje të shërbimit inspektive verifikime dhe shkyçje për mos pagesë, lidhjeve ilegale, legalizim të konsumatorëve, ankesa të konsumatorëve, arkëtimin e borgjeve dhe aktivitete të tjera.

Me prioritet janë proceduar rastet e konsumatorëve që kanë borgje mbi 200€ dhe që paraprakisht nuk u janë përgjigjur vërejtjeve paralajmëruese për shkyçje

- Këto aktivitete mund të shihen në tabelën vijuese:

- **RAPORT I EKIPEVE TË INPEKTORIATIT – TM2 2025**

Njesite operative	Shpërndarja e njoftimeve paralajmëruese për pembarim/shkyçje	Shkyçjet - Lidhjet e paligjshme	Shkyçjet për mos pagesë	Nr. i shkyçjeve Totale	Verifikimi i leximit të ujëmatësve	Nr. i leximeve të gabuara	Rastet e dorezuar për gjykatë	Kontrata të riprogramimit
Prizren	302	151	588	734	1,477	9	0	10
Suharekë	918	83	106	186	806	5	0	6
Malishevë	817	11	47	61	1,015	5	0	19
Dragash	0	0	5	7	146	0	2	5
<b>TOTAL</b>	<b>2,037</b>	<b>245</b>	<b>746</b>	<b>988</b>	<b>3,445</b>	<b>19</b>	<b>2</b>	<b>40</b>

## 4 DEPARTAMENTI I FINANCAVE

### 4.1 Aktivitetet kryesore

Ky raport përfshinë të gjitha aktivitetet nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë konform rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një performacë sa më të mirë të kompanisë.

- Punët ditore te zakonshme, si regjistrimi i arkave në bazë ditore, regjistrimet furnitorëve, depove si dhe aseteve për muajt përkatës.
- Përgatitja e raporteve mujore e tre muroje për institucionet përkatëse, si ARRU, ASK, ME etj.
- Hapja dhe përgatitja e pagave për muajin përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punësuarve.
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amvisërisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Pranimi, kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, aprovimi i tyre për blerje dhe shpërndarja e materialit të blerë;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Barazimet e rregullta të arkave mobile me dorëzimin e mjeteve në bankë apo arken kryesore;
- Barazimet e rregullta të furnitorëve, pagesat e rregullta, sipas blerjeve;
- Regjistrimi i investimeve kapitale si dhe raportimi i tyre;
- Regjistrimet ditore në kontabilitet të hyrje/daljeve të materialit në depo;
- Plotësimin e librit të blerjes dhe shitjes sipas kërkesës nga ATK, për muajin përkatës;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj, sipas ligjeve në fuqi;
- Takimet e rregullta me menaxhmentin e kompanisë, lidhur me performancën dhe prezantimin e rekomandimeve për aktivitete të tjera për performacë më të mirë të kompanisë;
- Deklarimi i PF për vitin 2025 ne EDI sipas KKRF-së sipas si dhe dorëzimi i tyre në KKRF

## 4.2 Faturimi €

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN  
TM1-TM2- 2025

FATURIMI - €			
No.	Të dhënat	TM1- 2025	TM2- 2025
1	Faturimi-€	1,345,043.32	1,456,526.71
2	Total- Shte.	1,032,769.40	1,112,766.91
3	Ndryshimi		79,997.51
4	Ndry. %		7.7%
5	Total- kome.	201,778.24	208,923.00
6	Ndryshimi		7,144.76
7	Ndry. %		3.5%
8	Total-Inst.	110,495.68	134,836.80
9	Ndryshimi		24,341.12
10	Ndry. %		22.0%
11	Te tjera	6,920.91	9,877.63
12	<b>Total</b>	<b>1,351,964.23</b>	<b>1,466,404.34</b>
13	Ndryshimi		114,440.11
14	Ndry. %		8.5%

## 4.3 Arkëtimi €

TM1-TM2 - 2025

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

No.	Të dhënat	TM1- 2025	TM2- 2025
1	Total- Shtëpiak	1,003,333.19	1,044,431.10
2	Ndryshimi		41,097.91
3	Ndry. %		4.1%
4	Total-Komercial-Industrial	201,866.62	200,936.17
5	Ndryshimi		(930.45)
6	Ndry. %		-0.5%
7	Total Institucional	115,533.20	114,547.97
8	Ndryshimi		(985.23)
9	Ndry. %		-0.9%
10	Total - ujë	1,320,733.01	1,359,915.24

11	Ndryshimi		39,182.23
12	Ndry. %		3.0%
13	Te tjera	4,996.51	6,866.80
14	Ndryshimi		1,870.29
15	Ndry. %		37.4%
16	TOTAL	1,325,729.52	1,366,782.04
17	Ndryshimi		41,032.52
18	Ndry. %		3.10%

#### 4.4 Arsyeshmëria e shpenzimeve

**K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A -  
PRIZREN  
TM1-TM2- 2025**

SHPENZIMET - €					
No.		TM- 2025	TM2- 2025	DALLIM	%
1	Total Shpenzimet Operative	1,247,049.45	1,397,749.12	150,699.67	12.08%
2	Pagat	781,851.45	808,876.40	27,024.95	3.46%
3	Rryma elektrike	268,928.48	382,132.18	113,203.70	42.09%
4	Shpen. e derivateve	29,720.60	23,597.54	-6,123.06	-20.60%
5	Mirem. dhe riparimet	72,240.61	67,547.80	-4,692.81	-6.50%
6	Mirem. e automjeteve	8,262.46	31,322.16	23,059.70	279.09%
7	Shpen.e taksave	26,419.15	27,978.48	1,559.33	5.90%
8	Kemikaliet	6,146.09	3,905.33	-2,240.76	-36.46%
9	Shpenzimet e tjera	53,480.61	52,389.23	-1,091.38	-2.04%

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e II-të 2025, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të I-rë 2025 janë për 12 % më të larta;  
Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo rënies së tyre;

Në pozicionin e pagave kemi një rritje të shpenzimeve në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyet se në muajin mars e prill kemi dhënë bonus për të gjithë punëtorët si dhe maj e qershor, sipas vendimeve të K.E., kemi rritur pagat për 50 euro për të gjithë stafin në mënyrë lineare. Pra, kjo ka ndikuar direkt në rritjen e shpenzimeve të pagave për këtë tre mujor;

Ndërsa te pozicioni i energjisë elektrike, sipas vlerës, kemi rritjen me të madhe për këtë tremujor, për shkak të ndryshimit të cmimit tarifor në muajin maj, si dhe në qershor, me energji elektrike, jemi furnizuar dhe faturuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) KEK-u dhe me këtë rast ka ndryshuar edhe cmimi i energjisë, në krahasim me muajin prill dhe maj;

Te shpenzimet tek pozicioni i derivateve në krahasim me tremujorin e kaluar, kemi rënie të shpenzimeve për 20 % janë më të ulëta, pra këto shpenzime varen edhe nga angazhimi i makinerisë, apo edhe ndërrim i vajrave të tyre si dhe sa ato derivate janë shfrytëzuar për ngrohje qëndrore;

Gjithashtu rënie të lehtë kemi edhe te shpenzimet e kategorisë së mirëmbajtjes në rrjet dhe në mirëmbajtjen e pompave. Pasi në tremujorin e kaluar, përveç intervenimeve në rrjet, kemi pasur edhe shumë intervenime në ndërrimin e ujëmatësave;

Ndërsa rritje të dukshme kemi pasur te shpenzimet e pozicionit të mirëmbajtjes së automjeteve, pothuajse në të gjitha njësitë, pasi që tremujorin e kaluar kemi pasur më pak riparime. Vlenë të theksohet fakti së për këtë kategori të shpenzimeve, nga janari 2025 nuk kemi ndonjë kontratë aktive për riparime dhe furnizime me autopjesë. Edhe pse kemi kërkesa të shumta për servisim dhe riparim të automjeteve, të cilat janë kryer në këtë tremujor pasi që është nënshkruar kontrata në prill, pra kjo ka ndikuar edhe në këtë ndryshim të madh të shpenzimeve;

Gjithashtu rritje të lehtë kemi pasur te shpenzimet e taksave, për shkak se në këtë tremujor, kemi pasur më shumë lëndë të dërguara tek përmbaruesi, ndërsa shpenzimet e tjera jo pse kanë ndryshuar shumë, si ato të SHUKOS dhe të ARRU-së;

Rënie të shpenzimeve kemi tek shpenzimet e kategorisë të tjera, pra në këtë kategori ku përfshihen shpenzimet administrative, shpenzimet të jashtme profesionale, siç janë shpenzimet për mirëmbajtje të softuerit, mirëmbajtje për GPS, shpenzimet e provizioneve;

Pra si përfundim, shpenzimet totale, për këtë tremujor kanë qenë më të larta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyet e cekura më lartë.

## 4.5 Transaksionet kryesore

### 10 pagesat me te mëdha nga Hidroregjioni Jugor për Operatorët TM2- 2025

Data	Nr. i dokumentit	Emri I operatorit	Shuma -€
4/23/2025	BPBPZNPOS-010537	UNISOFT N.T.SH. Arianit R.Bytyqi B.I.	39,800.00
6/13/2025	BPBPZNPOS-010805	CO-ING Afrim S. Ibrahimimi	37,621.40
4/25/2025	BPBPZNPOS-010537	EC-Consulting SH.P.K.	32,928.50
6/25/2025	BPBPZNPOS-010855	KEK - Bunari I	31,393.02
6/4/2025	TEB-SH-000004809	NPT Xerxa	29,633.00
5/21/2025	BPBPZNPOS-010631	KEK - Bunari I	25,396.30
4/23/2025	BPBPZNPOS-010537	KEK - Bunari I	24,837.33
6/4/2025	BPBPZNPOS-010766	Hidro Project	24,003.90
4/11/2025	BPBPZNPOS-010537	Muratori sh.p.k.	22,973.20
4/15/2025	BPBPZNPOS-010537	CO-ING Afrim S. Ibrahimimi	22,260.98
<b>TOTAL</b>			<b>290,847.63</b>

### 10 pagesat me te mëdha ndaj Hidroregjioni Jugor për TM2- 2025

Data	Emri I konsumatorit	Kategoria	Shuma -€
26.06.2025	Qendra Medicinale SPITALI	INSTITUCIO	12,436.18
03.06.2025	Qendra Medicinale SPITALI	INSTITUCIO	11,577.10
29.04.2025	Qendra Medicinale SPITALI	INSTITUCIO	9,963.35
27.06.2025	Stadiumi "Përparim Thaqi"	INSTITUCIO	8,229.99

28.04.2025	Agim E Demollari Lum Myharemi Exfis SH P K	LOKALET	3,919.36
22.04.2025	Sh.f.m.u "Abdyl Frashëri"	INSTITUCIO	2,978.62
22.04.2025	Sh.M.Ultë Hysen Rexhepi	INSTITUCIO	2,880.36
19.05.2025	Shadervani-krojet	INSTITUCIO	2,874.96
22.04.2025	Sh.m.I Gjimnazi "Gjon Buzuku"	INSTITUCIO	2,481.87
02.06.2025	Rraman Elez Kurtaj	SHTEPI..F	2,228.96
<b>TOTAL</b>			<b>59,570.75</b>

## 5 DEPARTAMENTI I UJËRAVE TË NDOTURA

### 5.1 Aktivitetet e përgjithshme

Angazhim dhe menaxhim i përditshëm i aktiviteteve që kanë të bëjnë me operim, funksionim dhe optimizim të ITUN-se në Prizren dhe aktivitete të vazhdueshme për konsolidim të Departamentit të Ujërave të Ndotura,

Takimet e rregullta të menaxhmentit, takimet virtuale me donatore të huaj dhe vendor, me institucionet komunale, qeveritare, me konsumator, me konsulencat e projektit dhe me kontraktoret etj.,

Shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike, harmonizimi i aktiviteteve për ITUN-ne aktuale dhe projektet tjera potenciale të cilat mund të përfitohen në të ardhmen në këtë sektor,

Angazhimi si kryetar i komisionit për projektin Rehabilitimi i sistemit të kanalizimit në qytetin e Prizrenit Faza V dhe VI, përmes korrespondencave të vazhdueshme me konsulencën e projektit dhe KfW-ne si agjencion financues i këtij projekti,

Monitorimi, krahasimi dhe aplikimi i testeve të analizave në laboratorin e ITUN-se,

Takime të rregullta mujore me stafin aktual të ITUN-se,

Procedimi i kërkesave logjistike dhe atyre investive për nevojat e ITUN-se,

Vizite në punishte gjatë realizimit të projekteve në baza ditore-Inspektimi i punimeve dhe koordinimi i aktiviteteve,

Takim i rregullt mujor me konsulencën SPR&Hidroring dhe kontraktorin Alb Star, me temën Progresi i punimeve për projektin "Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për qytetin e Prizrenit" Faza V dhe VI,

### 5.2 Statusi i projektit, Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Prizrenit-Faza V dhe VI

Ky projekt është bërë i mundur falë bashkëpunimit ndërqeveritar në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës Federale Gjermane, përmes KfW-së, e cila pandërprerë ka financuar projektet kryesore për qytetarët e Prizrenit.

Një ndër kushtet e përfitimit të këtij granti ka qenë edhe vendosja e rrjetit të kanalizimit në gjeoreferncë, konkretisht në sistemin e GIS-it me të gjitha imputet teknike, kjo është realizuar

nga Departamenti ynë dhe aktualisht sistemi i rrjetit të kanalizimit në kompanin tonë mund të themi se është me i konsoliduari në nivel sektori.

Prandaj i jemi mirënjohës dhe falënderojmë taksapaguesit Gjermanë për ndihmën e panderprerë e cila ka ndikuar pozitivisht në ngritjen socio-ekonomike për qytetarët e Kosovës e në veçanti për qytetarët e Prizrenit.

**Po raportojmë të dhënat për TM2 /2025 që kanë të bëjnë me progresin e këtij projekti:**

Emri i projektit	<i>Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për qytetin e Prizrenit</i>
Nënshkrimi i kontratës:	<i>07 nentor 2022</i>
Data e fillimit:	<i>21 nentor 2022</i>
Vlera e kontratës:	<i>4,297,232.00 Euro</i>
Kompletimi i projektit:	<i>18 muaj ose 547 ditë nga data e fillimit</i>
Agjencioni financues:	<i>KfW-Banka Gjermane për Zhvillim</i>
Detyrat e kontratës:	<i>Ndërrimi i rrjetit të kanalizimit duke filluar nga Ø150mm deri në Ø 800 mm</i>
Gjatësia e ndërrimit të kanalizimit:	<i>Rreth 7.7 km</i>
Zona e projektit:	<i>Qyteti i Prizrenit, zonat problematike në aspektin e funksionimit</i>
Përfitues:	<i>KRU"Hidroregjioni Jugor"Sh.a</i>
Mbikqyrja:	<i>Konsulenca e projektit SRP&amp;Hidroing</i>
Fillimi punimeve në teren:	<i>24.03.2023</i>
Koha aktuale e kontratës:	<i>547 ditë</i>
Ditët e mbetura:	<i>0 ditë</i>
Koha e përfundimit:	<i>21.05.2024</i>
Periudha e defekteve DNP	<i>21.05.2024</i>
Koha e vazhduar e kontratës	<i>08.11.2024</i>

Sa i përket këtij projekti, projekti ka përfunduar, aktualisht jemi në fazën e DNP-se (Defect Notification Period), që nënkupton në Periudhën e njoftimit të defekteve, për pjesën e prehilitimit me metoden Kanal i Hapur periudha e njoftimit të defekteve do të përfundojë me 31.07.2025, kurse për një pjesë të punimeve konkretisht për punimet e rehabilitimit të rrjetit të kanalizimit me metodën e INLINING-ut kjo periudhë do të përfundojë në muajin 4/2026, deri në fund të këtij muaji çdo defekt i cili njoftohet nga konsumatorët tek HRJ si dhe defekte të njoftuara nga ne si kompani, të gjitha do të sanohen nga ana e kontraktorit sepse sipas kontratës kontraktorit i janë mbajtur 10% e pagesës e cila do të transferohet kontraktorit pas muajit 4/2026. Aktualisht jemi duke përgatitur dokumentacionin për inspektimin final të rrugëve të cilat janë rehabilituar me metodën e kanalit të hapur, ky inspektim është planifikuar të përfundojë gjatë muajit Korrik/2025, konkretisht para skadimit të DNP-se. Nëse eventualisht nuk janë riparuar të gjeturat e inspektimeve paraprake atëherë do të shtyhet periudha e njoftimit të defekteve deri në një afat kur kontraktori do të deklarojë se do të sanojë të gjitha të gjeturat nga inspektimi final. Sa i përket regjistrimit të këtij projekti si aset në kontabilitet, ne jemi duke i përgatitur të gjitha dokumentacionet për secilën rrugë veç e veç.

Për rrugët të cilat janë rehabilituar me metodën e kanalit të hapur dokumentacionet do të përgatiten dhe do të dorëzohen në kontabilitet brenda vitit 2025, kurse për rrugët të cilat janë rehabilituar me metodën e INLINING-ut do të kompletohen dhe do të dorëzohet në kontabilitet pasi të përfundon periudha e DNP-se, e Njoftimit të Defekteve, pra pas muajit

4/2026. Sa i përket VO7, I cili ka te beje me blerjen e pajisjeve nga mjetet te cilat kanë mbetur nga disa prej marrëveshjeve financiare me KfW-ne dhe nga mjetet e kontos se veçantë te HRJ-se, këto blerje parashohin furnizimin me kamionete dhe 2 pompa thithëse t cilat do te shërbejnë për thithjen e ujit te ndotur ne interceptor dhe gjate defekteve potenciale ne sistemin e kanalizimit. Konkretisht tabelën me pajisjet dhe rrjedhjen e parave për këtë projekt do ta paraqes ne raportin TM2 i cili është përpiluar nga konsulenca e projektit dhe është miratuar nga KfW. Përmes këtij raporti, ju njoftoj për Letrën Zotuese te nënshkruar nga Komuna e Prizrenit, KfW dhe HRJ, me temën:

Rehabilitimi rrjetit te kanalizimit ne rrugën TIRANA

Sipas kësaj letre, te gjitha palët nënshkruese kanë marr për obligim si vijon:

***Komuna bie dakord të planifikojë në buxhet, të prokurojë, të zbatojë dhe të paguajë kostot e lidhura me punimet e rehabilitimit përfshirë dhe rrugën TIRANA (Rruga Tirana do te prokurohet nga komuna vetëm për vendosjen e materialit ne vepër sepse materiali për rrugën Tirana është blere nga KfW dhe aktualisht ndodhet ne Depon e HRJ-se) në një shumë të vlerësuar deri në 1 milion euro.***

Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit do të kryhet nga Hidroregjioni.

Hidroregjioni do të mbetet përgjegjëse ndaj KfW-së për vlerën (170,000 euro) të materialit të prokuruar deri në momentin kur instalimi i tij të dokumentohet siç duhet pranë KfW-së.

Komuna dhe RWC Hidroregjioni angazhohen që të përfundojnë punimet e mbetura përgjatë Rrugës së Tiranës sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se data 30 dhjetor 2025.

Komuna dhe RWC Hidroregjioni bien dakord të përdorin fondet e mbetura nga Faza I dhe II (BMZ nr. 201065663, 201266089) për të shlyer detyrimet ndaj kontraktorit dhe për të mbuluar çdo mungesë fondesh që mund të paraqitet në Fazën V dhe VI pas zbatimit të punimeve të kontraktuara.

Deri me tani kur po raportojmë, kemi pas një takim ne zyrën e drejtorit te DSHP-se, ku kemi diskutuar ne lidhje me këtë letër zotuese, i njëjti nuk ka dhënë ndonjë indicie se kjo Letër Zotuese do te implementohet gjate këtij viti.

Me date 16.06.2025, Komuna e Prizrenit, konkretisht kryetari z Totaj dhe Drejtori I DSHP-se z. Lamaj, përmes emalit zyrtar te kompanisë janë lajmëruar zyrtarisht respektivisht janë ftuar nga HRJ për te filluar diskutimet për zbatimin e kësaj letre te nënshkruar nga palët.

Komuna e Prizrenit, konkretisht Drejtori Lamaj na është përgjigjur me email, se projektin e rrugës Tirana munde ta fillojnë nga muaji (Nëntor dhe Dhjetor)/2025.

#### **Trajtimi i ujit te ndotur m<sup>3</sup> - TM2-2025**

Muaji	Uji ne hyrje m <sup>3</sup> /muaj	Uji ricikluar- m <sup>3</sup> /muaj	Uji i trajtuar (m <sup>3</sup> /muaj)
Prill	311,474	65,948	325,903
Maj	332,683	71,848	354,652
Qershor	289,048	68,658	309,358
Total	933,205	933,205	933,205

Stabilizimi i llumit m3 - TM2-2025

Muaji	Llumi pompuar nga sedimentuesi primar m3/muaj	Llumi pompuar nga sedimentuesi sekondar- m3/muaj	Llumi i deponuar ne shtreter (m3/muaj)
Prill	431	287	5
Maj	396	294	4
Qershor	247	363	71
<b>Total</b>	<b>1074</b>	<b>944</b>	<b>80</b>

Mirëmbajtja e planifikuar sipas aplikacionit MMS –TM2-2025

Muaji	Trajtimi Mekanik	Trajtimi Biologjik	Trajtimi I Llumit
Prill	295	315	272
Maj	270	305	215
Qershor	255	289	202
<b>Total</b>	<b>820</b>	<b>909</b>	<b>689</b>

Mirëmbajtja emergjente sipas aplikacionit MMS –TM2-2025

Muaji	Trajtimi Mekanik	Trajtimi Biologjik	Trajtimi I Llumit
Prill	2	1	1
Maj	4	4	2
Qershor	5	1	3
<b>Total</b>	<b>11</b>	<b>6</b>	<b>6</b>

Mirëmbajtja emergjente e sistemit te kanalizimit me aplikacioni MMS, TM2-2025

Muaji	Kontrolli i kanalizimit [m]	Kontrolli I pusetave[cope]	Pastrimi i kanalizimit [m]	Pastrimi I pusetave [cope]	Pastrimi i throtlave dhe kaperderdhesve
Prill	2,620	114	2,620	105	-
Maj	2,510	99	2,510	99	-
Qershor	2,395	129	2,395	129	-
<b>TM2</b>	<b>7,525</b>	<b>342</b>	<b>7,525</b>	<b>333</b>	<b>-</b>

TM2-2025

Njesia	Kontrolli i kanalizimit [m]	Kontrolli I pusetave (copë)	Pastrimi i kanalizimit (m)	Pastrimi I pusetave (copë)
Prizren	4,465	224	4465	224
Suhareke	1,290	29	1290	29
Malisheve	620	45	620	45
Dragash	1,150	44	1150	35
<b>KRU- TM2-</b>	<b>7,525</b>	<b>342</b>	<b>7,525</b>	<b>333</b>

## VI. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

### 6.1 Aktivitetet kryesore

Përshkrimi	Prill	Maj	Qershor	Totali
Aktvendime me aprovime të pjesshme	1	1	/	2
Aktvendime në favor të kompanisë nga Gykata Themelore	1	/	/	1
Aktvendime kundër kompanisë nga Gykata Themelore	1	1	/	2
Aktvendime në favor të kompa. nga Gykata e Apelit	/	/	/	/
Aktvendime kundër kompanisë nga Gykata e Apelit	/	/	/	/
Seanca gjyqësore	6	6	3	15
Padi kundër kompanisë	/	1	1	2
Përgjigje në Padi nga kompania	/	1	1	2
Padi nga kompania	/	/	/	/
Aktgjykimi në favor të kompanisë	/	/	/	/
Aktgjykim kundër kompanisë	/	/	/	/
Aktvendim për tërheqje të padisë	/	1	/	1
Aktvendim nga Gykata Komerçiale	1	1	/	2

#### 6.1.1 Kallëzime penale

Përshkrimi	Prill	Maj	Qershor	Totali
PRIZREN	0	0	0	0
SUHAREKË	0	0	2	2
MALISHEVË	0	0	1	1
DRAGASH	0	0	1	1
<b>TOTAL-KRU</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>4</b>

#### 6.1.2 Procedurat përmbartimore

Nr	Njësia Operative	Procedurat përmbartimore
1	Prizren	16
2	Suharekë	29
3	Malishevë	13
4	Dragash	0
5	<b>Total</b>	<b>58</b>

### 6.1.3 Të hyrat nga përmbaruesit privat

TM2-2025

Njësia	Nr. rasteve	TM2 - Totali (€)	Shuma e inkasuar
Prizren	16	10,856.28 €	23,208.05 €
Malishevë	13	12,457.24 €	4,257.55 €
Suharekë	29	18,343.20 €	7,625.57 €
Dragash	0	- €	240.00 €
<b>Totali</b>	<b>58</b>	<b>41,656.72 €</b>	<b>35,331.17 €</b>

### 6.1.4 Aktivitetet nga Burimet Njerëzore

TM1-2025

Nr	Përshkrimi	Numri i punëtorëve
1	Pushim vjetor	264
2	Pushim mjekësor	47
3	Pushim mjekësor me kompensim	1
4	Pushim pa pagesë	3
5	Pensionim	1
6	Pushim për rast vdekje	3
7	Vërejtje për punëtorët	0
8	Ndërprerje e kontratës me vetë dëshirë	0
9	Shkarkim dhe ndërprerje e kontratës	0
10	Janë punësuar	3
11	Largim i përkohshëm (suspendim)	1
12	Pushim të lehonisë	5
13	Pushim të lehonisë (per burra)	1

### 6.1.5 Personeli

TM2-2025

